anomalisht të ulët, në rastin kur ekzistojnë tre ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

O - Oferta

MO – Mesatarja e ofertave të vlefshme

N - Numri i ofertave të vlefshme

PR (Zm) – Zbritje e mundshme

$$MO = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N$$

$$PR = 85 \% Mo$$

Vlera e ofertave të vlerësuara < .. PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ulët.

3. Nëse një Operator Ekonomik nuk pranon korrigjimin e gabimeve aritmetike, ose nëse Ofertuesi nuk arrin të japë një justifikim për të bindur Autoritetin/Entin Kontraktor, në rast të një oferte anomalisht të ulët, Oferta e tij do të refuzohet.

4. Procesi i hedhjes së shortit

Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë të njëjtat pikë, atëherë fituesi përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Ofertuesit njoftohen për datën dhe kohën e hedhjes së shortit. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën arsye për skualifikim.

D. DHËNIA E KONTRATËS

23. Njoftimi i Fituesit

1. Brenda afatit të vlefshmërisë së Ofertës, Autoriteti/Enti Kontraktor njofton Operatorin Ekonomik të suksesshëm se, Oferta e tij është pranuar, dhe është shpallur fituese.

24. Nënshkrimi i Marrëveshjes Kuadër/ Kontratës

1. Pas konfirmimit të fituesit/ve Autoriteti/Enti Kontraktor përgatit, nënshkruan dhe fton Operatorin/ët e suksesshëm Ekonomik të nënshkruajë Marrëveshjen kuadër/Kontratën.

2. Autoriteti/Enti Kontraktor i kërkon fituesit një sigurim për realizimin e Kontratës. Shuma e mbulimit për realizimin e kontratës do të jetë 10% e vlerës së Kontratës. Formulari i Sigurimit të Kontratës, dorëzohet

para nënshkrimit të Kontratës.

Sigurimi për realizimin e kontratës mund të paraqitet në një nga format e mëposhtme:

- a) mundësi pagese nga ofertuesi në vlerë monetare, në llogarinë e autoritetit ose entit kontraktor;
- b) garanci bankare
- c) garanci nga shoqëri sigurimi.

DH. ANKESAT

25. Procedura e ankesës

1. Çdo Operator Ekonomik, i cili ka interes të ligjshëm për objektin e prokurimit dhe rrezikon të dëmtohet nga vendimmarrja e autoritetit/entit kontraktor mund të paraqesë ankesë njëkohësisht pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në lidhje me Dokumentet e Tenderit, kualifikimin, përzgjedhjen ose përcaktimin e ofertës fituese, sipas parashikimeve në LPP dhe aktet nënligjore, në Sistemin e Ankesave Elektronike.
2. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

3. Autoriteti/Enti Kontraktor mund t'i kërkojë Komisionit të Prokurimit Publik që të lëshojë masa të ndërmjetme për mospezullimin e procedurës së prokurimit.

E. ANULIMI I PROCEDURËS

26. Anulimi i procedurës

1. Autoriteti / Enti kontraktor publikon Njoftimin për

Anulimin e Procedurës së Prokurimit, në të njëjtën mënyrë siç publikon Njoftimin e Kontratës, jo më vonë se 5 (pesë) ditë nga data e skadimit të afatit të fundit për paraqitjen e ankesave, ose dhënien e vendimit përfundimtar për ankimin.

2. Autoriteti/ enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur:

a) nuk është paraqitur asnjë kërkesë e përshtatshme në procedurat me faza;

b) nuk është paraqitur asnjë ofertë e përshtatshme në procedurat me një fazë;

c) konstaton se dokumentet e tenderit përmbajnë gabime ose mangësi të rëndësishme;

d) për shkak të rrethanave të paparashikueshme dhe objektive, nevojat ose aftësia paguese e autoritetit ose entit kontraktor ka ndryshuar;

e) Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin në përputhje me parashikimet në LPP;

Gjithashtu, Titullari i autoritetit/entit vendos anulimin e procedurës sipas përcaktimeve në nenin 19 të LPP dhe nenin 75 të VKM 285/2021, të ndryshuar.

3. Kur procedura e prokurimit publik anulohet në përputhje me shkronjën "d" të paragrafit 2, autoriteti/ enti kontraktor nuk duhet të shpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna.

4. Nëse, Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të rishpallë një procedurë të re për të njëjtin objekt të prokurimit dhe me të njëjtat të dhëna, nuk duhet të vijojë me rishpalljen e saj në Sistemin e Prokurimit Elektronik përpara përfundimit të afateve të ankimimit/shqyrtimit të ankesave dhe vendimit të marrë lidhur me to.

SEKSIONI II: LISTA E SHTOJCAVE

Shtojca 1: Formulari i Ofertës [Ekonomike](#)

Shtojca 2: Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit

Shtojca 3: Formulari i Sigurimit të Ofertës

Shtojca 4: Lista e Informacionit Konfidencial

Shtojca 5: Deklaratë mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Shtojca 6: Formulari i Specifikimeve Teknike

Shtojca 7: Formulari i Shërbimeve dhe Grafikut të ekzekutimit

Shtojca 8: Formulari i Termave të Referencës

Shtojca 9: Formulari i Kritereve të Përzgjedhjes së Ofertuesve

Shtojca 10: Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit

Shtojca 11: Formulari i Njoftimit të skualifikimit

Shtojca 12: Formulari i Njoftimit të Fituesit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 13: Formulari i Njoftimit të Fituesit, në përfundim të afateve të ankimimit

Shtojca 14: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit.

Shtojca 15: Formulari i Njoftimit të Operatorëve Ekonomikë të Suksesshëm në Marrëveshjen Kuadër, në përfundim të afateve të ankimimit.

Shtojca 16: Formulari i Njoftimit të Anulimit të Procedurës së Prokurimit, pas publikimit të të cilit fillojnë afatet e ankimimit

Shtojca 1.

(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI I OFERTËS EKONOMIKE⁵

Data:

Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:

Për: **[Operatori Ekonomik shënon emrin e Autoritetit/Entit Kontraktor]**

Emri i ofertuesit dhe NIPT-i **[Operatori Ekonomik shënon emrin e ofertuesit dhe NIPT-in]**

Ne, të nënshkruarit, deklarojmë se:

- (a) Kemi konsultuar dhe nuk kemi asnjë rezervë për Dokumentet e Tenderit të procedurës me objekt:**[shënoni objektin e procedurës së prokurimit të publikuar në SPE]**, përfshirë sqarimet dhe Shtojcat e nxjerra.
- (b) Ne **[vendos emrin e Operatorit Ekonomik dhe numrin unik të identifikimit, dhe/ose anëtarët e BOE, nëse është rasti]**, nuk jemi -të përjashtuar nga e drejta për të fituar kontrata publike dhe jemi në përputhje me kërkesat e kualifikimit dhe kërkesat specifike të kontratës siç specifikohet në njoftimin e kontratës **[vendos objektin e procedurës së prokurimit/lotit]**.
- (c) Ne ofrojmë të kryejmë për Autoritetin/Entin Kontraktor **[vendos emrin e Autoritetit/entit Kontraktor]**, në përputhje me Dokumentet e Tenderit (shih më poshtë), Shërbimet për **[vendosni CPV-në e procedurës/Lotit përkatës nga Njoftimi i Kontratës të publikuar në SPE]** në përputhje me Ofertën Teknike, me çmimet e renditura në Listën e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit dhe në përputhje me Termat dhe Kushtet e Kontratës, të cilat reflektohen në Dokumentet e Tenderit.
 - (d) Oferta jonë është në përputhje me dokumentet e mëposhtme:
 - 1. Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë;
 - 2. Njoftimin e Kontratës;
 - 3. Kriteret e Përzgjedhjes;
 - 4. Specifikimet teknike, grafikun e ekzekutimit dhe termat e referencës;
 - 5. Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
 - 6. Kushtet e Veçanta të Kontratës;

⁵ Vlera e ofertës ekonomike nuk duhet të kalojë dy shifra pas presjes dhjetore.

7. Lista e Çmimeve sipas elementëve përbërës të shërbimit.

- (e) Çmimi total i Ofertës sonë, **pa TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**
- (f) Çmimi total i Ofertës sonë, **me TVSH**, është: ----- **[Operatori Ekonomik e vendos në shifra dhe fjalë];**

Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 2.*(Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)***LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ELEMENTËVE PËRBËRËS TË SHËRBIMIT****Data:** _____**Numri i referencës së procedurës së prokurimit/lotit:**
_____**Emri dhe numri unik i identifikimit të Operatorit Ekonomik/Operatorëve ekonomikë (në rast BOE):** _____**Monedha:** _____

Në rast të mospërputhjes midis çmimit për njësi dhe totalit, do të zbatohen rregullat e përcaktuara në Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Çmimet dhe monedhat të jenë në përputhje me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë.

Të gjithë elementëve përbërës të ofertës ekonomike duhet t'u vendoset çmimi i ofruar në këtë Listë, pasi elementët e Ofertës Ekonomike pa vlerë do të konsiderohen si shërbime të paofruara dhe do të cojnë në refuzimin e ofertës.

1	2	3	4	5	
Nr.	Përshkrimi i elementëve të përbërës të Ofertës Ekonomike	Sasia	çmimi për njësi	Çmimi total (3 x 4X)	
1.					
2.					
3.					
4					
	Çmimi total				_____
Çmimi Neto pa TVSH					
TVSH (%)					

Çmimi total me TVSH:	
Emri i përfaqësuesit të ofertuesit	
Nënshkrimi	
Vula	
Datë _____	

Shtojca 3.

[Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

* * *

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërmbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës së prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]

Shtojca 4.

(Shtojcë për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial)

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

like ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Përfaqësuesi i Ofertuesit

Nënshkrimi

Vula

Shtojca 5.

(⁶Shtojcë për t'u plotësuar nga operatori ekonomik)

DEKLARATË

Mbi disponueshmërinë e anëtarit të stafit

Deklaratë për procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Unë i nënshkruari _____, në cilësinë e anëtarit të stafit të operatorit ekonomik “.....” për procedurën e prokurimit me objekt _____ nën përgjegjësinë time personale, **Deklaroj** se:

1. Autorizoj VETËM operatorin ekonomik “.....” të paraqesë personin tim dhe të gjithë dokumentacion e nevojshëm, si anëtar i stafit të tij në procedurën e prokurimit publik që do të zhvillohet në datë _____ nga Autoriteti/Enti Kontraktor _____ me objekt _____ me fond limit _____.

Deklarimi i personit tim, si anëtar i stafit nga ana e çdo operatori ekonomik tjetër, për procedurën e prokurimit me objektështë i pamiratuar dhe pa pëlqimin e personit tim.

2. Jam i disponueshëm në realizimin e objektit të prokurimit, sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor.

Data e dorëzimit të deklaratës _____

Emri, Mbiemri, Nënshkrimi

Vula

⁶ Kjo Shtojcë do të paraqitet në rastin e kontratave për shërbime me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posaçme.

Shtojca 6.

[*Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor*]

FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

Specifikimet Teknike të shërbimeve objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

SHËNIM: Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Në hartimin e specifikimeve teknike, autoritetet /entet kontraktore mbajnë në konsideratë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin përkatës në fushat, si më poshtë:

- a) Kërkesat minimale të performancës së energjisë, siç përcaktohet në legjislacionin në fuqi për efikasitetin e energjisë dhe për performancën energjetike në ndërtesa, konsumin e energjisë dhe burimeve të tjera të produkteve me ndikim në energji, përfshirë parashikimet për përdorimin e etiketave për produktet me ndikim në energji;
- b) Specifikimet teknike për produkte të caktuara, siç përcaktohet në aktet ligjore dhe nënligjore të fushës me qëllim përmirësimin e performancës energjetike dhe uljen e ndikimit;
- c) Çdo parashikim tjetër që buron nga legjislacioni mjedisor, energjetik, social dhe i punës.

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kërkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

SPECIFIKIMET TEKNIKE

Për

“Mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS Papillon 9”.

Instituti i Policisë Shkencore kërkon të realizojë shërbimin për mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS 9”. Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi dhe realizimi i praktikave si më poshtë:

- Identifikimi i shpejtë i të gjithë të ndaluarve/arrestuarve, personave të depërtuar, emigrantët e paligjshme me anën e gjurmëve të gishtave të sistemin Afis/Apis.
- Krahasoni automatik në sistemin Afis/Apis të gjurmëve të duarve të personave të ndaluar/arrestuar, personave deportiv me qëllim identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve që janë administruar si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.
- Identifikimin e menjëhershëm me gjurmët e gishtave të të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalimit Kontrollit.
- Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin Afis/Apis të imazheve të gjurmëve të duarve që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim identifikimin e autorit me anën e gjurmëve të gishtave në databazën e këtij sistemi brenda ditës.
- Krijimin e mundësisë për të kaluar në krahasimin automatik të të dhënave daktiloskopike midis sistemit tonë Afis/Apis dhe sistemeve të 10 vendet anëtare të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Evropës Juglindore(PCC SEE) si Austria, Hungaria, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina dhe Moldavia.

Për të realizuar mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS 9” operatori ekonomik duhet :

- Te sigurojë mbështetje teknike për pajisjet hardweret speciale kamera TVC9, skavera te sheshte Epson perfection V800 dhe software.
- Te mbështes blerësin me materiale te përditësuar për periudhën e mbështetjes.
- Te ekzekutojë këshillat e operatoreve te sistemit me anën e linjës telefonike, faks, shërbim postar, poste elektronike, hot line open VPN etj, si dhe me material informues falas.
- Te shpërndajë ndryshime dhe shtesa me anën e postes elektronike ose me anën e CD pa asnjë pagese shtese.
- Te rivendose operativitetin e sistemit brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit me shkrim rreth defektit. Termat nuk përfshijnë zgjatjen e udhëtimit te ekspertit te

shitësit ne vend, zgjatjen e dërgimit te pajisjeve ne vendin e riparimit dhe kthim. Operativiteti i sistemin kupton mundësinë e sistemit për te ekzekutuar futjen e informacionit ne databaze, realizimin e kërkimeve ne databaze, leximin e listës se kandidateve, arshivimet ne databaze.

- Te kontrolloje dhe riparoje te gjitha gabimet ne sistemin e skedarëve për kërkimin automatik, kalibrimin, indeksimin, rrjetit, listës se kandidateve, serverat shpejtues, serverin e bakupit dhe ne postet e punës te sistemit.
- Te pastroje nga pluhuri serverat sidomos serverin qendor, serverat shpejtues, serverin e backupit dhe postet e punës.
- Te zëvendësoje pajisjet speciale te Sistemeve, te specifikuara ne **listën e pajisjeve speciale dhe softwareve prodhim Papillon Afis**, brenda një muaji ne qofte se operativiteti i këtyre Sistemeve nuk është dhunuar. Ky term nuk përfshin kohen e dërgimit dhe te kthimit mbrapsh te këtyre pajisjeve ne vendin përkatës derisa ato te riparohen. Pajisjet e Sistemeve te përcaktuar ne **listën e pajisjeve speciale dhe softwareve prodhim Papillon Afis** duhet te zëvendësohen me pajisje qe kane te njëjtat karakteristika teknike si ato origjinale ose te dhëna teknike me te mira.
- Mbështetja për Sistemin do te behte nëpërmjet lidhjes “hot- line ne te gjithë ditët e punës nga ora 08:00 deri 16:30 sipas orës lokale.

Blerësi duhet:

1. Te përdori pajisjet dhe softweret sipas instruksioneve te prodhuesit dhe manualit te përdorimit te sistemit Afis Papillon 9.
2. Te ekzekutoje procedurat e arshivimit dhe vendosjen ne databaze sipas instruksioneve te manualit te përdorimit te sistemit Afis Papillon.
3. Te përdori sistemin nga specialiste qe janë certifikuar nga shitësi qe provojnë kualifikimin e nevojshëm.
4. Te mbështes operimin e pajisjeve speciale dhe softveve Papillon.
5. Te japë këshilla ne lidhje me operimin e Sistemeve (me anën e telefonit, faksit, postes elektronike e-mail etj) si dhe duke siguruar falas materiale informuese.
6. Te dërgoje falas me anën e postes elektronike, postes ose me CD si dhe te beje instalimin e softwareve shtese.
7. Te rivendose operativitetin e Sistemeve brenda 20 diteve kalendarike nga data e njoftimit për mosfunksionimin. Me operativitet te Sistemeve kuptohet aftësia e Sistemeve për te ekzekutuar: futjen e informacionin ne databaze, ekzekutimin dhe krahasimi i gjurmeve kundrejt gjithë databazes, shikimin e listës se kandidateve dhe arkivimet ne databaze.
8. Te riparoje hardwaret e dëmtuara te Sistemeve si skanerë, kamerën dixhitale dhe softwaret te specifikuara ne lidhjen Nr.1 kur mosfunksionimi i tyre është shkaktuar dëmtimet e këtyre hardwareve.
9. Te zëvendësoje pajisjet speciale te Sistemeve, te specifikuara ne lidhjen Nr.1 brenda një muaji ne qofte se operativiteti i këtyre Sistemeve nuk është dhunuar. Ky term nuk përfshin kohen e dërgimit dhe te kthimit mbrapsh te këtyre pajisjeve ne vendin përkatës derisa ato te riparohen.

10. Pajisjet e Sistemeve te përmendura ne lidhjen Nr. 1 duhet te zëvendësohen me pajisje qe kane te njëjtat karakteristika teknike si ato origjinale ose te dhëna teknike me te mira.
11. Mbështetja për Sistemet do te behete nëpërmjet lidhjes telefonike ne te gjithë ditët e punës nga ora 08:00 deri 16:30 sipas orës lokale.

Lista Nr. 1 e paisjeve speciale dhe softeve prodhim Papillon Afis që përfshihen në mbështetjen teknike është si më poshtë :

Nr.	Paisjet speciale dhe softwaret	Njesia	Sasia
1	Kamer dixhitale Papillon TVC-9 me objektiv Gelios	Cope	1
2	Panel pershtates per kameran dixhitale Papillon, v-9	Cope	1
3	Objektiv dhe mbajtes objektivi Papillon	Cope	1
4	Software Papillon AFIS per serverin qendror	Cope	1
5	Software Papillon AFIS per serverat shpejtues te dyfishte	Cope	4
6	Software Papillon AFIS per postet e punes te sistemit AFIS	Cope	5
7	Software papillon Afis per serverin e kontrollit te identitetit	Cope	1
8	Skaner i sheshte Epson perfection V800 photo	Cope	5

Shënim: Në respektim të LPP, në të gjitha rastet kur përmendet “markë” përfshihet termi “ekuivalente”.

Shtojca 7.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

(Kjo Shtojcë në rastin e Marrëveshjes Kuadër do të plotësohet nga autoriteti/enti kontraktor vetëm gjatë rihapjes së procesit të mini-konkursit)

FORMULARI I SHËRBIMEVE DHE GRAFIKUT TË EKZEKUTIMIT

Shërbimi që kërkohet:

Mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS 9”.

Për të realizuar mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS 9” operatori ekonomik duhet:

- Te siguroje mbështetje teknike për pajisjet hardware speciale kamera TVC9, skanera te sheshte Epson perfection V800 dhe software.
- Te mbështes blerësin me materiale te përditësuara për periudhën e mbështetjes.
- Te ekzekutoje këshillat e operatoreve te sistemit me anën e linjës telefonike, faks, shërbim postar, poste elektronike, hot line open VPN etj, si dhe me material informues falas.
- Te shpërndajë ndryshime dhe shtesa me anën e postes elektronike ose me anën e CD pa asnjë pagese shtese.
- Te rivendose operativitetin e sistemit brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit me shkrim rreth defektit. Termat nuk përfshijnë zgjatjen e udhëtimit te ekspertit te shitësit ne vend, zgjatjen e dërgimit te pajisjeve ne vendin e riparimit dhe kthim. Operativiteti i sistemin kupton mundësinë e sistemit për te ekzekutuar futjen e informacionit ne databaze, realizimin e kërkimeve ne databaze, leximin e listës se kandidateve, arshivimet ne databaze.
- Te kontrolloje dhe riparoje te gjitha gabimet ne sistemin e skedarëve për kërkimin automatik, kalibrimin, indeksimin, rrjetit, listës se kandidateve, serverat shpejtues, serverin e backupit dhe ne postet e punës te sistemit.
- Te pastroje nga pluhuri serverat sidomos serverin qendror, serverat shpejtues, serverin e backupit dhe postet e punës.
- Te zëvendësoje pajisjet speciale te Sistemeve, te specifikuara ne **listën e pajisjeve speciale dhe softwareve prodhim Papillon Afis**, brenda një muaji ne qofte se operativiteti i këtyre Sistemeve nuk është dhunuar. Ky term nuk përfshin kohen e dërgimit dhe te kthimit mbrapsh te këtyre pajisjeve ne vendin përkatës derisa ato te riparohen. Pajisjet e Sistemeve te përcaktuar ne **listën e pajisjeve speciale dhe softwareve prodhim Papillon Afis** duhet te zëvendësohen me pajisje qe kane te njëjtat karakteristika teknike si ato origjinale ose te dhëna teknike me te mira.

- Mbështetja për Sistemin do të behet nëpërmjet lidhjes hot- line ne te gjithë ditët e punës nga ora 08:00 deri 16:30 sipas orës lokale.

Lista Nr. 1 e paisjeve speciale dhe softveve prodhim Papillon Afis që përfshihen në mbështetjen teknike është si më poshtë :

Nr.	Paisjet speciale dhe softwaret	Njesia	Sasia
1	Kamer dixhitale Papillon TVC-9 me objektiv Gelios	Cope	1
2	Panel pershtates per kameran dixhitale Papillon, v-9	Cope	1
3	Objektiv dhe mbajtes objektivi Papillon	Cope	1
4	Software Papillon AFIS per serverin qendror	Cope	1
5	Software Papillon AFIS per serverat shpejtues te dyfishte	Cope	4
6	Software Papillon AFIS per postet e punes te sistemit AFIS	Cope	5
7	Software papillon Afis per serverin e kontrollit te identitetit	Cope	1
8	Skaner i sheshte Epson perfection V800 photo	Cope	5

Afatet e ekzekutimit:

- Rivendosja e operativitetit të sistemit të bëhet brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit me shkrim rreth defektit. Termat nuk përfshijnë zgjatjen e udhëtimit të ekspertit të shitësit në vend, zgjatjen e dërgimit të pajisjeve në vendin e riparimit dhe kthim.
- Zëvendësimi i pajisjeve speciale të Sistemeve, të specifikuar në **listën e pajisjeve speciale dhe softwareve prodhim Papillon Afis**, të bëhet brenda një muaji në qoftë se operativiteti i këtyre Sistemeve nuk është dhunuar. Ky term nuk përfshin kohën e dërgimit dhe të kthimit mbrapsh të këtyre pajisjeve në vendin përkatës derisa ato të riparohen.
- Mbështetja për Sistemin do të behet nëpërmjet lidhjes hot- line ne te gjitha ditët e punës nga ora 08:00 deri 16:30 sipas orës lokale.
- Kohëzgjatja e kontratës do të jetë 36 muaj nga momenti i nënshkrimit të kontratës.

Shtojca 8.

(Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor)

FORMULARI I TERMAVE TË REFERENCËS

Objekti dhe qëllimi i shërbimeve:

Instituti i Policisë Shkencore kërkon të realizojë shërbimin për mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS 9". Me realizimin e këtij shërbimi synohet sigurimi dhe realizimi i praktikave si më poshtë:

- Identifikimi i shpejtë i të gjithë të ndaluarve/arrestuarve, personave të depërtuar, emigrantët e paligjshme me anën e gjurmëve të gishtave të sistemit Afis/Apis.
- Krahësimi automatik në sistemin Afis/Apis të gjurmëve të duarve të personave të ndaluar/arrestuar, personave deportiv me qëllim identifikimin e shpejtë të gjurmëve të duarve që janë administruar si prova shkencore në çështjet penale në hetim apo të pezulluara.
- Identifikimin e menjëhershëm me gjurmët e gishtave të të gjithë personave që janë shpallur në kërkim dhe kërkojnë të kalojnë në Pikat e Kalimit Kontrollit.
- Dërgimi on-line në kohë reale direkt në sistemin Afis/Apis të imazheve të gjurmëve të duarve që do të zbulohen dhe administrohen si prova shkencore në vendet e ngjarjeve (kryesisht për ngjarjet e rënda) me qëllim identifikimin e autorit me anën e gjurmëve të gishtave në databazën e këtij sistemi brenda ditës.
- Krijimin e mundësisë për të kaluar në krahasimin automatik të të dhënave daktiloskopike midis sistemit tonë Afis/Apis dhe sistemeve të 10 vendet anëtare të Konventës së Bashkëpunimit Policor të Vendeve të Evropës Juglindore (PCC SEE) si Austria, Hungaria, Sllovenia, Bullgaria, Rumania, Serbia, Maqedonia, Mali i Zi, Bosnje Hercegovina dhe Moldavia.

Detyrat:

Për të realizuar mirëmbajtje teknike të sistemit AFIS 9" operatori ekonomik duhet :

- Te sigurojë mbështetje teknike për pajisjet hardweret speciale kamera TVC9, skavera te sheshte Epson perfection V800 dhe software.
- Te mbështes blerësin me materiale te updeituara për periudhën e mbështetjes.
- Te ekzekutojë këshillat e operatoreve te sistemit me anën e linjës telefonike, faks, shërbim postar, poste elektronike, hot line open VPN etj, si dhe me material informues falas.

- Te shpërndajë ndryshime dhe shtesa me anën e postes elektronike ose me anën e CD pa asnjë pagesë shtese.
- Te rivendose operativitetin e sistemit brenda 10 ditëve kalendarike nga dita e njoftimit me shkrim rreth defektit. Termat nuk përfshijnë zgjatjen e udhëtimit të ekspertit të shitësit në vend, zgjatjen e dërgimit të pajisjeve në vendin e riparimit dhe kthim. Operativiteti i sistemin kupton mundësinë e sistemit për të ekzekutuar futjen e informacionit në databazë, realizimin e kërkimeve në databazë, leximin e listës së kandidatëve, arshivimet në databazë.
- Te kontrollojë dhe riparojë të gjitha gabimet në sistemin e skedarëve për kërkimin automatik, kalibrimin, indeksimin, rrjetit, listës së kandidatëve, serverat shpejtues, serverin e backupit dhe në postet e punës të sistemit.
- Te pastrojë nga pluhuri serverat sidomos serverin qendror, serverat shpejtues, serverin e backupit dhe postet e punës.
- Te zëvendësojë pajisjet speciale të Sistemeve, të specifikuara në **listën e pajisjeve speciale dhe softwereve prodhim Papillon Afis**, brenda një muaji në qoftë se operativiteti i këtyre Sistemeve nuk është dhunuar. Ky term nuk përfshin kohën e dërgimit dhe të kthimit mbrapsh të këtyre pajisjeve në vendin përkatës derisa ato të riparohen. Pajisjet e Sistemeve të përcaktuara në **listën e pajisjeve speciale dhe softwereve prodhim Papillon Afis** duhet të zëvendësohen me pajisje që kanë të njëjtat karakteristika teknike si ato origjinale ose të dhëna teknike me të mira.
- Mbështetja për Sistemin do të bëhet nëpërmjet lidhjes “hot- line” në të gjithë ditët e punës nga ora 08:00 deri 16:30 sipas orës lokale.

Blerësi duhet:

1. Te përdori pajisjet dhe softweret sipas instruksioneve të prodhuesit dhe manualit të përdorimit të sistemit Afis Papillon 9.
2. Te ekzekutojë procedurat e arshivimit dhe vendosjen në databazë sipas instruksioneve të manualit të përdorimit të sistemit Afis Papillon.
3. Te përdori sistemin nga specialiste që janë certifikuar nga shitësi që provojnë kualifikimin e nevojshëm.
4. Te mbështes operimin e pajisjeve speciale dhe softwereve Papillon.
5. Te japë këshilla në lidhje me operimin e Sistemeve (me anën e telefonit, faksit, postes elektronike e-mail etj) si dhe duke siguruar falas materiale informuese.
6. Te dërgojë falas me anën e postes elektronike, postes ose me CD si dhe të bëjë instalimin e softwereve shtese.
7. Te rivendose operativitetin e Sistemeve brenda 20 ditëve kalendarike nga data e njoftimit për mosfunksionimin. Me operativitetin e Sistemeve kuptohet aftësia e Sistemeve për të ekzekutuar : futjen e informacionit në databazë, ekzekutimin dhe krahasimin i gjurmëve kundrejt gjithë databazës, shikimin e listës së kandidatëve dhe arkivimet në databazë.
8. Te riparojë hardwaret e dëmtuara të Sistemeve si skanerë, kamerën dixhitale dhe softweret të specifikuara në lidhjen Nr.1 kur mosfunksionimi i tyre është shkaktuar dëmtimet e këtyre hardwareve.
9. Te zëvendësojë pajisjet speciale të Sistemeve, të specifikuara në lidhjen Nr.1 brenda një muaji në qoftë se operativiteti i këtyre Sistemeve nuk është dhunuar. Ky term nuk

përfshin kohen e dërgimit dhe të kthimit mbrapsh të këtyre pajisjeve në vendin përkatës derisa ato të riparohen.

10. Pajisjet e Sistemeve të përmendura në lidhjen Nr. 1 duhet të zëvendësohen me pajisje që kanë të njëjtat karakteristika teknike si ato origjinale ose të dhëna teknike me të mira.
11. Mbështetja për Sistemet do të bëhet nëpërmjet lidhjes telefonike në të gjithë ditët e punës nga ora 08:00 deri 16:30 sipas orës lokale.

Lista Nr. 1 e pajisjeve speciale dhe softveve prodhim Papillon Afis që përfshihen në mbështetjen teknike është si më poshtë :

Nr.	Pajisjet speciale dhe softwaret	Njesia	Sasia
1	Kamer dixhitale Papillon TVC-9 me objektiv Gelios	Cope	1
2	Panel pershtates per kameran dixhitale Papillon, v-9	Cope	1
3	Objektiv dhe mbajtes objektivi Papillon	Cope	1
4	Software Papillon AFIS per serverin qendror	Cope	1
5	Software Papillon AFIS per serverat shpejtues te dyfishte	Cope	4
6	Software Papillon AFIS per postet e punes te sistemit AFIS	Cope	5
7	Software papillon Afis per serverin e kontrollit te identitetit	Cope	1
8	Skaner i sheshte Epson perfection V800 photo	Cope	5

Shpërndarja: Realizimi i shërbimit do të kryhet nga momenti i nënshkrimit të kontratës deri në 36 muaj sipas afateve të ekzekutimit në **Shtojcën 7**.

Vendi i kryerjes së shërbimeve: Ky projekt do të zbatohet në Tiranë.

Shtojca 9

[Shtojcë për t'u plotësuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor]

FORMULAR I I KRITEREVE TË PËRZGJEDHJES/KUALIFIKIMIT

1. KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT

Ofertuesi deklaron se:

- a) është i regjistruar në regjistrin tregtar sipas legjislacionit të vendit ku ushtron aktivitetin, ose sipas legjislacionit të posaçëm në rastin e një organizate jofitimprurëse, ka në fushën e veprimtarisë objektin e prokurimit, dhe ka statusin aktiv;
- b) nuk është në proces falimentimi (status aktiv);
- c) nuk është dënuar për ndonjë vepër penale, në përputhje me nenin 76/1 të LPP-së;
- ç) personi (personat) që veprojnë si anëtar i organit administrativ, drejtori ose mbikëqyrësi, aksioneri ose ortak, ose që ka fuqi përfaqësuese, vendimmarrëse ose kontrolluese brenda Operatorit Ekonomik, nuk është i dënuar ose nuk ka qenë i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për çdo vepër penale, të përcaktuar në nenin 76/1 të LPP-së;
- d) nuk është shpallur fajtor për shkelje të rëndë profesionale, për sa kohë që nuk është parashkruar, sipas legjislacionit në fuqi;
- dh) nuk ka pagesa të pashlyera të taksave dhe kontributeve të sigurimeve shoqërore, ose ndodhet në një prej kushteve të parashikuara në nenin 76/2 të LPP-së;
- e) ka paguar energjinë elektrike dhe plotëson kërkesat që burojnë nga legjislacioni në fuqi. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, të cilët operojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë.
- f) nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi;
- g) ushtron veprimtarinë në përputhje me legjislacionin përkatës mjedisor, social dhe të punës;
- gj) ka paraqitur një Ofertë të Pavarur, sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi;
- h) kryen aktivitetin në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi.
- i) nuk ka në cilësinë e anëtarit të organit të administrimit, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak, ose me kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij persona të cilët janë/kanë qenë në këtë cilësi në një operator ekonomik të përjashtuar nga e

drejta për të fituar kontrata publike, me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik, gjatë kohës që ky vendim është në fuqi.

j) ka regjistruar pronarët përfitues në regjistrin e pronarëve përfitues, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi;

k) zbaton detyrimet që rrjedhin nga legjislacioni në fuqi për pagat bazë referuese për kategori profesioni për punonjësit e pajtuar në punë. Ky informacion kërkohet për Operatorët Ekonomikë, i regjistruar në regjistrin tregtar shqiptar.

Këto kritere duhet të përmbushen me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 10.

Në rast bashkimi të operatorëve ekonomikë, secili anëtar i grupit duhet të paraqesë Vetëdeklarimin e lartpërmendur.

Në rast se, operatori ekonomik ofertues do të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, Vetëdeklarimi i lartpërmendur duhet të paraqitet edhe nga subjekti mbështetës.

Kriteret e Përgjithshme të Pranimit nuk duhet të ndryshohen nga Autoritetet/Entet Kontraktore.

Në çdo rast, Autoriteti/EntiKontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme për vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga Operatori Ekonomik, për sa më sipër.

➤ Nëse oferta paraqitet nga një bashkim Operatorësh Ekonomikë, do të paraqitet :

Marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Operatorëve Ekonomikë, ku caktohet përfaqësuesi, përqindja e pjesëmarrjes në bashkim, dhe elementët që merr përsipër të realizojë secili prej anëtarëve të bashkimit.

➤ Nëse, një operator ekonomik dëshiron të mbështetet në kapacitetet e subjekteve të tjera, ai i vërteton autoritetit ose entit kontraktor se do të ketë në dispozicion burimet e nevojshme, duke dorëzuar një angazhim me shkrim të këtyre subjekteve për këtë qëllim.

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës 10.*

b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas përcaktimeve në Shtojcën 9, pika 1 të DST "Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes/kualifikimit".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare para zhvillimit të procedurës, ku vlera e xhiros, për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar, duhet të jetë jo më e vogël se vlera e perlllogaritur e kontratës që prokurohet.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin kopje të çertifikuara të balanceve të tre viteve të fundit financiare para zhvillimit të procedurës, të paraqitura pranë autoriteteve përkatëse tatimore. Në rast se operatori ekonomik është në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të ligjit nr. 10091, datë 05.03.2009, atëherë bilancet duhet të shoqërohen edhe me *raportet e auditimit ligjor të pasqyrave financiare vjetore, të kryera, nga auditues ligjorë ose shoqëri audituese. Kriteri konsiderohet i përmbushuar nëse në dy balance të njëpasnjëshme nuk ka raport negative ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 30 % të vlerës së perlllogaritur të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore ku të shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.
- b)** për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruar në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur dhe te paraqesë Certifikatat ose ekuivalentet e tyre, të cilat duhet të perkojnë me kategorinë dhe specifikën e produkteve që prokurohen, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si me poshte:

- a) ISO 9001:2015 “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” (AK pranon dhe certifikatën për standardin e përditësuar ISO 9001:2024)
- b) ISO 27001:2017 “Menaxhimi i sigurisë së informacionit” (pranohen dhe standartet e përditësuara)

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojces Nr. 10, të DST-ve dhe në zbatim të V.K.M – së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”, **si më sipër.**

Forma ligjore e paraqitjes së dokumentacionit për operatorët pjesëmarrës:

Operatorët e huaj ekonomik, duhet të paraqesin të gjithë dokumentacionin të certifikuar “Apostille”. Për vendet që nuk kanë ratifikuar Konventën e Hagës, datë 5 tetor 1961, “për heqjen e kërkesës për legalizim diplomatik e konsullor të dokumenteve zyrtare të huaja”, duhet të bëhen legalizimet në ambasadat dhe konsullatat shqiptare ose zyrat respektive nga vendi i origjinës. (Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues).

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Shënim: Në zbatim të pikës 1, të Nenit 26, të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet: “Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”, si dhe përcaktimet e pikës 6, të këtij neni, ku parashikohet: “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Shtojca 10.

(Shtojcë për tu paraqitur nga operatori ekonomik)

FORMULARI PËRMBLEDHËS I VETËDEKLARIMIT

I. Unë i nënshkruari _____ në cilësinë e _____ të operatorit ekonomik
_____ deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë që:

A. Pjesa I: Informacion në lidhje me Operatorin Ekonomik

Identifikimi	Përgjigjja
Emri i operatorit ekonomik: (Ju lutemi renditni të gjithë operatorët ekonomikë nëse jeni një BOE. Ju lutemi tregoni rolin e operatorit ekonomik në BOE	-----
Numri NIPT/et:	-----
Adresa postare: Qyteti / qyteti; Kodi postar	-----
Përfaqësuesi (emri):	-----
Telefoni:	-----
E-mail:	----- ----

B: DEKLARATË

Për nënkontraktorët dhe subjektet në kapacitetet, e të cilave do të mbështetet Operatori Ekonomik (nëse është e zbatueshme)

Në cilësinë e operatorit ekonomik, deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë se:

- **Informacione për nënkontraktorin**

Emri i nënkontraktorit të propozuar	NIPT –i	Përqindja e nënkontraktimit	Mallrat/ shërbimet e lidhura me to për t'u nënkontraktuar

• Informacion mbi subjektet mbi kapacitetin, e të cilëve do të mbështetet operatori ekonomik

Emri (at) e subjekteve	NIPT-i	Lloji i kapacitetit për të cilin do të mbështetet operatori ekonomik	Specifiko konkretisht kapacitetin/et

Pjesa II: Shkaqet e përjashtimit

A: DEKLARATA PËR PËRMBUSHJEN E KRITEREVE TË PËRGJITHSHME TË KUALIFIKIMIT

Deklarata
